

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXV, nr. 7967  
E hënë, 13 janar 2025  
Çmimi 0.50

Rohde për dialogun:  
Zgjidhjet politike, çelësi  
për një siguri të  
qëndrueshme në Kosovë

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
www.awr-abbruch.de

## OPOZITA HAP FUSHATËN ME TUBIME MADHËSHTORE

FAQE 2



Subjektet politike që garojnë për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit kanë hyrë zyrtarisht në fushatë zgjedhore e cila do të zgjasë deri në orën 07:00 të datës 9 shkurt, kur edhe do të nisë

votimi. Në këtë garë zgjedhore marrin pjesë 28 subjekte politike me gjithsej 1 280 kandidatë. Ish-kryeministra e ish-ministra synojnë ta udhëheqin qeverinë e re. Të shtunën

fushatën zgjedhore e kanë hapur LV-ja, PDK-ja, LDK-ja dhe Koalicioni për Familjen, ndërkaq të dielën koalicioni AAK-Nisma. Tubimet hapëse të opozitës ishin madhështore

O'BRIEN: KOSOVA  
E SERBIA DUHET  
TË ECIN PËRPARA  
PËR HIR TË SË  
ARDHMES SË TYRE  
EVROPIANE F.3



OSMANI NË TAKIM ME KRYETARIN E  
BUJANOCIT: KOSOVA DO TË VAZHDOJË  
T'I MBËSHTESË SHQIPTARËT E LUGINËS F.6



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### AKTUALE



JACK SMITH JEP DORËHEQJE NGA  
DEPARTAMENTI I DREJTËSISË F.2

SHËNOJNË RËNIE RASTET ME  
VIRUSIN HMPV NË KINË, THONË  
ZYRTARËT F.2

KURTI SHKON TEK OBSERVATORI  
DHE PLANETARIUMI KOMBËTAR  
I KOSOVËS, FTON QYTETARËT  
TA VIZITOJNË ME FËMIJËT F.6

### EKONOMI



NGA JANARI PAGAT DALIN ME  
RRITJE, POR PSE S'U TRAJTUAN  
DILEMAT LIGJORE? F.7

ÇFARË IMPORTOI E EKSPORTOI  
KOSOVA GJATË VITIT 2024? F.7

### SPORT



TRIUMOJNË PRISHTINA,  
BASHKIMI DHE PEJA F.10

# Shënojnë rënie rastet me virusin HMPV në Kinë, thonë zyrtarët

**ZHEJIANG, 12 JANAR** - Shkalla e infektimit me virusin e ngjashëm me gripin, metapneumovirus (HMPV), është duke shënuar rënie në veri të Kinës, thanë zyrtarët shëndetësorë të dielën. Rritja e rasteve me HMPV javë më parë kishte ngjallur frikën për përhapjen e një pandemie në mbarë botën.

HMPV-ja, e cila i përket së njëjtës familje si virusi sincial respirator, shkakton simptoma të ngjashme me gripin ose ftohjen, përfshirë ethe, kollë dhe kongjestion nazal.

Simptomat shpesh zhduken vetë, megjithëse ato mund të shkaktojnë infeksione të traktit të poshtëm respirator te fëmijët, tek të moshuarit dhe tek ata me imunitet të kompromentuar. "Metapneumovirusi njerëzor nuk është virus i ri, sepse ka qenë i pranishëm te njerëzit për të paktën disa dekada", tha Wang Liping, hulumtuuese në Qendrën Kineze për

Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve në një konferencë për shtyp nga Komisioni Kombëtar i Shëndetësisë së Kinës.

Wang shtoi se rritja e rasteve të virusit në vitet e fundit, i zbuluar për herë të parë në Holandë në vitin 2001, lidhet me metoda më të mira zbulimi. "Aktualisht shkalla e rasteve pozitive në zbulimin e metapneumovirusit njerëzor po luhet, ndërsa shkalla e rasteve pozitive në provincat veriore është në rënie, dhe shkalla e rasteve pozitive te pacientët nën moshën 14-vjeçare ka filluar të bjerë", tha ajo.

Shqetësimet u rritën ditët e fundit lidhur me rritjen e infeksioneve me HMPV në Kinën veriore, pasi u shpërndanë pamje në internet që treguan spitale të mbushura me pacientë me maska. Organizata Botërore e Shëndetësisë tha se nuk është njoftuar për shpërthime të pazakonta të infeksioneve në



Kinë apo diku tjetër. Javën e kaluar Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës njoftoi të hënën qytetarët e vendit me informacione thelbësore lidhur me këtë, me qëllim rritjen e masave të kujdesit parandalues. Instituti tha se nuk kishte ndonjë rast me HMPV në Kosovë.

Ekspertët thonë se HMPV-ja nuk është si Covid-19, pasi ka qenë i pranishëm për dekada dhe ekziston një imunitet i ndërtuar kundër tij. Shumica e fëmijëve infektohen me këtë virus deri në moshën pesëvjeçare. Wang tha se sëmundjet respiratore që po i prekin njerëzit në këtë kohë në Kinë, shkaktohen nga patogjenë të

njohur dhe nuk janë shfaqur sëmundje të reja infektive.

Numri i pacientëve në klinika dhe reparte të emergjencës në mbarë vendin është në rritje por, përgjithësisht, më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, tha Gao Xinqiang,

zëvendësrektor i Departamentit të Reagimit të Urgjencës Mjekësore të Komisionit të Shëndetësisë.

Numri i të prekurve nga gripi në të gjithë vendin pritet të bjerë gradualisht në mesin ose fundin e janarit, tha Hu Qiangqiang.

Aktualisht nuk ka trajtim specifik ose vaksinë për HMPV dhe kujdesi mjekësor është kryesisht simptomatik dhe virusi zakonisht kalon vetë.

Ekspertët këshillojnë masa parandaluese kundër marrjes së virusit dhe sëmundjeve të tjera respiratore, siç është larja e duarve rregullisht, shmangia e vendeve të mbipoplluara dhe bartja e maskës në vende të mbipoplluara.

## Jack Smith jep dorëheqje nga Departamenti i Drejtësisë

**WASHINGTON, 12 JANAR** - Prokurori i Posaçëm, Jack Smith, ka dhënë dorëheqje nga Departamenti i Drejtësisë, pasi e ka dorëzuar raportin hetues ndaj presidentit të zgjedhur amerikan, Donald Trump.

Departamenti i Drejtësisë bëri me dije për largimin e tij të shtunën mbrëma, duke thënë se ai dha dorëheqje të premtën.

Dorëheqja e tij, 10 ditë para se Trumpi ta marrë detyrën, vjen pas përfundimit të pasuksesshëm të dy ndjekjeve penale kundër Trumpit, të cilat pushuan pasi Trumpi i fitoi zgjedhjet presidenciale në nëntor.

Tash çështje është fati i një raporti dyvolumesh që Smithi dhe ekipi i tij e kishin përgatitur gjatë hetimit të tyre të dyfishtë për përpjekjet e Trumpit për ta zhbërë humbjen e tij kundër presidentit Joe Biden në zgjedhjet e vitit 2020 dhe keqpërdorimin e dokumenteve të klasifikuara në resorin e tij, Mar-a-Lago.

Departamenti i Drejtësisë pritej

ta bënte publik raportin në ditët e fundit të administratës Biden, por një gjykatëse e emëruar nga Trumpi, e cila e udhëhoqi rastin e dokumenteve të klasifikuara, e pranoi kërkesën e mbrojtjes që publikimi i raportit të shtyhej të paktën përkohësisht.

Dy nga bashkëpunëtorët e Trumpit në atë rast, shërbyesit e tij personal, Walt Nauta, dhe menaxheri i pronës në Mar-a-Lago, Carlos De Oliveira, argumentuan se publikimi i raportit do të ishte padrejtësisht paragjyqës, një argument që edhe ekipi ligjor i Trumpit e mbështeti.

Departamenti u përgjigj duke thënë se do ta mbante të fshehtë nga publikimi vëllimin e dokumenteve të klasifikuara për atë kohë që proceset penale kundër Nautas dhe De Oliveiras mbeten pezull. Megjithatë, prokurorët thanë se e kanë ndër mend të vazhdojnë publikimin e vëllimit që lidhet me ndërhyrjen në zgjedhje.

Në një mocion urgjent të premtën mbrëma, ata kërkuan

nga Gjykata e Apelit me bazë në Atlanta që ta heqë menjëherë një ndalesë të vendosur nga gjykatësja e Qarkut Aileen Cannon, e cila kishte ndaluar publikimin e ndonjë pjese të raportit.

Ata i thanë veçmas Cannonit të shtunën se ajo nuk ka autoritet për ta ndaluar publikimin e raportit, por ajo u përgjigj me një urdher që kërkonte nga prokurorët të dorëzonin një material shtesë deri të dielën.

Gjykata e Apelit e hodhi poshtë të enjten një kërkesë urgjente të mbrojtjes për ta bllokuar publikimin e raportit për ndërhyrjen në zgjedhje, i cili mbulon përpjekjet e Trumpit para trazirave në Kongres më 6 janar 2021 për ta zhbërë rezultatin e zgjedhjeve të 2020-s. Por, gjykata e la në fuqi ndalesën e Cannonit që asnjë nga gjetjet nuk mund të publikohen deri tri ditë pas zgjidhjes së çështjes nga Gjykata e Apelit.

Departamenti i Drejtësisë i tha Gjykatës së Apelit në mocionin e tij urgjent se urdhri i Cannonit ishte



"qartësisht i gabuar".

Rregulloret e Departamentit të Drejtësisë kërkojnë që prokurorët e posaçëm të përpilojnë raporte në përfundim të punës së tyre, dhe është zakon që dokumente të tilla të bëhen publike pavarësisht prej temës së tyre.

William Barr, prokuror i përgjithshëm gjatë mandatit të parë të Trumpit, e publikoi një raport të prokurorit të posaçëm

që shqyrtonte ndërhyrjen ruse në zgjedhjet presidenciale në ShBA më 2016, dhe lidhjet e mundshme me fushatën e Trumpit.

Prokurori i përgjithshëm i Bidenit, Merrick Garland, ka publikuar gjithashtu raporte të prokurorëve të posaçëm, përfshirë ato për trajtimin e informacionit të klasifikuar nga Bideni përpara se të bëhej president.

## ShBA-ja kërkon që Rusia të ketë "zero" pronësi në NIS

**WASHINGTON, 12 JANAR** - Kushti i vetëm i Shteteve të Bashkuara për Industrinë e Naftës së Serbisë (NIS) është që të mos ketë rrjedhë të parasë drejt Ruisisë, tha

ndihmëssekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien.

Zyrtari amerikan tha se ShBA-ja nuk dëshiron që Moska ta

udhëheqë NIS-in. "E vetmja mënyrë që rreziku të jetë zero, është që pjesa e pronësisë ruse të jetë zero. Ky është qëndrimi me të cilin hyjmë në këtë bisedë. Ne

tashmë e kemi bërë këtë gjë me kompani të tjera ruse në vende të tjera si, Holandë, Zvicër dhe Turqi", tha O'Brien të dielën për Radiotelevizionin e Serbisë

(RTS).

Ai shtoi se ShBA-ja do ta ndjekë rrugën drejt, siç tha, pronësisë konstruktive të NIS-it nga e cila përfiton Serbia.

# O'Brien: Kosova e Serbia duhet të ecin përpara për hir të së ardhmes së tyre evropiane

PRISHTINË, 12 JANAR - Ndhmëssekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien, u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë t'i normalizojnë marrëdhëniet fqinjësore për hir të synimeve të veta për integritet evropiane.

Në një intervistë për tabloidin serb "Kurir", të publikuar të dielën, O'Brien tha se të dyja vendet kanë nevojë ta bëjnë këtë. "Mendoj se Kosova dhe Serbia duhet ta kuptojnë se ka rrugë normale evropiane për këtë çështje. Mendoj se tani, me një Bashkim Evropian më aktiv në rajon, të dyja vendet e kuptojnë se ka gjëra që secila prej tyre duhet t'i bëjë, të cilat do ta bëjnë më të lehtë zgjidhjen çështjeve", tha O'Brien. Por, shtoi ai, ato duhet ecin përpara dhe t'i bëjnë këto gjëra "për hir të rrugës së tyre evropiane, jo për shkak të disa negociatave të veçanta".

Kosova dhe Serbia zhvillojnë dialog për normalizim e marrëdhënies që nga viti 2011, ndërsa më 2023 arritën Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të raporteve dhe Aneksin për zbatimin e saj. Megjithatë, ato ende nuk kanë filluar ta zbatojnë këtë marrëveshje, sipas BE-së. Dialogu mes tyre, i

ndërmjetësuar nga BE-ja, mbështetet edhe nga Shtetet e Bashkuara.

O'Brien u pyet gjithashtu se a mund të jetojnë serbët e Kosovës nën udhëheqjen e kryeministrit Albin Kurti, pas një varg hapash që qeveria e tij i ndërmori gjatë vitit 2024 për t'i mbyllur institucionet paralele serbe në veriun e banuar me shumicë serbe dhe për ta shtrirë autoritetin atje. "Mendoj se po", u përgjig ai, duke shtuar se "praktikisht çdo vend evropian ka pasur nevojë të merret me një çështje të tillë - një komunitet që ndihet i lidhur me një vend fqinj për shkak të lidhjeve kombëtare, fetare apo historike".

Po ashtu, Kosova ka ndaluar përdorimin e dinarit serb, gjë që ka vështirësuar pagesën e pagave për pjesëtarët e komunitetit serb që marrin rroga nga buxheti i Serbisë.

Këto hapa Qeveria e Kosovës ka thënë se i ka ndërmarrë për ta shtrirë sovranitetin, por është kritikuar nga komuniteti ndërkombëtar që kërkon që këto çështje të zgjidhen në dialogun e Brukselit, në mënyrë që të shmangët rritja e tensioneve në terren.

Në anën tjetër, Serbia nuk pranon t'i mbyllë institucionet e saj në territorin e Kosovës dhe shumicën e tyre i ka



zhvendosur afër pikave kufitare nga ana e Serbisë.

Kosovës i kërkohet, gjithashtu, edhe themelimi i një Asociacioni të Komunave me Shumicë Serbe, por ajo ka shprehur drojën se një asociacion i tillë njëetnik mund të ndikojë në funksionimin e shtetit.

O'Brien bëri thirrje që serbëve në Kosovë, posaçërisht në veri, t'u jepet hapësirë ta thonë

fjalën e tyre vet, pa u ndikuar apo detyruar nga të tjerët. "Ne duam të shohim që zëri i vet serbëve, në veçanti në veri, por edhe në gjithë Kosovë, të dëgjohet, jo që ata të detyrohen të flasin në një mënyrë apo tjetër siç u leverdis njerëzve në cilindo kryeqytet. Ata duhet t'i kenë të drejtat si çdo qytetar tjetër në një vend demokratik", tha O'Brien.

Ai tha se i dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, dhe ekipi i tij, kanë bërë "punë të suksesshme falë së cilës ka zgjidhje për jetën e serbëve në Kosovë me respekt për ta si një komunitet, në mënyrë që ata të mund të jetojnë normalisht, ashtu si, për shembull, gjermanët në Itali ose holandezët në Belgjikë".

## Rohde për dialogun: Zgjidhjet politike, çelësi për një siguri të qëndrueshme në Kosovë

PRISHTINË, 12 JANAR - Përparimi i mëtejshëm në dialog është e vetmja rrugë përpara për Kosovën dhe Serbinë drejt Bashkimit Evropian, thotë ambasadori gjerman Jorn Rohde. Thëkson se vetëm vendet që e njohin njëra-tjetrën mund t'i bashkohen BE-së.

Në intervistën për "KosovaPress", Rohde flet për konkluzionet e fundit të Këshillit të BE-së për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, ndërkohë që nënvizon se pajtueshmëria e plotë me të gjitha marrëveshjet e bëra është në interesin e vërtetë të të dyja vendeve, Kosovës dhe Serbisë. "Në të kaluarën, dialogu solli rezultate thelbësore. Që nga viti 2011 më shumë se 30 marrëveshje janë arritur në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja dhe shumë prej tyre janë zbatuar gjithashtu. Përparimi i mëtejshëm në dialog është e vetmja rrugë përpara drejt rrugës së ardhshme të Kosovës dhe Serbisë drejt Bashkimit Evropian. Kjo u bë e qartë edhe nga Këshilli Evropian në takimin e tij më 17 dhjetor 2024, nga presidentja e Komisionit të BE-së, Ursula von der Leyen, komisionarja e re e zgjerimit Marta Kos si dhe nga përfaqësuesja e re e lartë, Kaja

Kallas", thotë ai.

Qeveria e Kosovës nuk e ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese draft-statutin e asociacionit të hartuar nga BE-ja. Porse, ambasadori gjerman në Kosovë thotë se Draft-statuti duhet të përcillet në Kushtetuese sa më parë. "Draft-statuti është një dokument i miratuar nga e gjithë BE-27 për ta zbatuar Marrëveshjen e Ohrit dhe për ta vazhduar procesin e normalizimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kujtojmë konkluzionet e fundit të Këshillit të BE-së: Drafti duhet të përcillet në Gjykatën Kushtetuese pa vonesa të mëtejshme".

Serbia nuk po i përmbush obligimet e saj në dialog, ndërkohë që ka miratuar dy projektligje që cenojnë sovranitetin e Kosovës. Projektligji për juridiksion gjyqësor në Kosovë dhe tjetri për shpalljen e Kosovës "zonë të mbrojtjes së veçantë sociale", janë dy projektligjet për të cilat Gjermania ka deklaruar se shkelin qartazi detyrimet e Serbisë nga dialogu me Kosovën në Bruksel. "Ministria e Jashtme e Gjermanisë e ka bërë të qartë publikisht se Serbia me këtë qartazi shkel detyrimet e saj në dialog. Në përgjithësi, as Kosova dhe as Serbia nuk janë duke



respektuar plotësisht marrëveshjet e tyre përkatëse të dialogut, duke penguar kështu rrugën e tyre të mëtejshme drejt Bashkimit Evropian. Pajtueshmëria e plotë me të gjitha marrëveshjet e bëra është në interesin e vërtetë të të dy vendeve".

Ai tregon se kur pritet të shqyrtohet kërkesa e Kosovës për statusin kandidat për anëtarësim në BE.

Sa i përket situatës së sigurisë në

vend, ambasadori Rohde thotë se ka potencial për të eskaluar. Pas sulmit terrorist në Ibër-Lepenç institucionet e Kosovës paralajmëruan se ka rrezik për përsëritje të akteve të tilla. Sipas ambasadorit gjerman, vetëm zgjidhjet politike garantojnë mjedis të qëndrueshëm dhe të sigurt në vend. "Ndaj vlerësimin e komandantit të KFOR-it se situata e sigurisë në Kosovë është e brishtë me potencial për

të eskaluar. Gjermania ka treguar gatishmërinë e saj për të kontribuar e për të garantuar një mjedis të sigurt duke katërfishuar kontingjentin gjerman të KFOR-it në fillim të këtij viti. Megjithatë, në fund të fundit, vetëm zgjidhjet politike do të garantojnë një mjedis të qëndrueshëm, të sigurt dhe stabil. Ne kemi nevojë për përparim thelbësor në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja", tha Rohde.



# Opozita hap fushatën me tubime madhështore

Subjektet politike që garojnë për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit kanë hyrë zyrtarisht në fushatë zgjedhore e cila do të zgjasë deri në orën 07:00 të datës 9 shkurt, kur edhe do të nisë votimi. Në këtë garë zgjedhore marrin pjesë 28 subjekte politike me gjithsej 1 280 kandidatë. Ish-kryeministra e ish-ministra synojnë ta udhëheqin qeverinë e re. Të shtunën fushatën zgjedhore e kanë hapur LV-ja, PDK-ja, LDK-ja dhe Koalicioni për Familjen, ndërkaq të dielën koalicioni AAK-Nisma. Tubimet hapëse të opozitës ishin madhështore

ardhshme, me qëllim vazhdimin dhe plotësimin e nevojave, kërkesave dhe qëllimeve të përbashkëta qytetare e kombëtare të Republikës së Kosovës.

Kurti falënderoi Gjakovën për përkrahjen e madhe që i ka dhënë qeverisë dhe shtetit nëpër sfidat që kemi kaluar. Ai u zotua se qeverisja e Lëvizjes Vetëvendosje nuk do t'i gënjejë e as zhgënjejë qytetarët dhe se bashkë me ta do të angazhohet cep më cep për një qeverisje që sjell zhvillim me punësim dhe garanton të drejtat e liritë për secilin pa dallim në Republikë. "Kemi nevojë që përditë, për çdo orë, gjithandej, të ngriheni bashkë me ne, të dëgjoheni bashkë me ne, të punoni bashkë me ne, të angazhoheni bashkë me ne, të bëhemi bashkë, të jemi bashkë, sepse bashkë fitojmë dhe vetëm bashkë duhet të fitojmë. Vetëm së bashku mund ta përparojmë Gjakovën dhe krejt Kosovën cep më cep. Le të jemi bashkë në punë, në

barazi e për begati, nga populli te Republika, nga Gjakova te Kosova, cep më cep pa korrupsion, me zemër drejt fitores, drejt 500 mijë zemrave që rrahin si një në numrin 118", ka theksuar kryeministri Kurti.

## Krasniqi dhe Hamza: Votoni 131 për një Kosovë më të mirë

Partia Demokratike e Kosovës ka nisur zyrtarisht fushatën elektorale për zgjedhjet e përgjithshme, në një atmosferë madhështore, në mesin e mijëra përkrahësve në kryeqytet. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, para të pranishmëve tha se Bedri Hamza është kryeministri më i mirë që mund ta ketë sot Kosova. "Sot qëndroj para jush për t'ju siguruar se ne ofrojmë një plan konkret, një program të detajuar dhe gjithëpërfshirës, realist dhe të realizueshëm, i

cili do ta përmirësojë cilësinë e jetës së qytetarëve tanë. Për ta bërë Kosovën ma të fortë! Për ta bërë Kosovën ma të mirë! Kjo është arsyeja pse zgjedhëm Bedri Hamzën që të na prijë në këto zgjedhje, sepse Kosovës i duhen aftësitë, përvoja dhe personaliteti i Bedriut për ta materializuar planin tonë transformues", ka theksuar Krasniqi.

Lideri i PDK-së tha se aq sa është krenar me Hamzën, punën dhe programin e tij, po aq mburret me listën e kandidatëve për deputetë nga radhët e PDK-së, e cila është lista ma e mirë në këto zgjedhje, lista fituese. "Një listë me personalitete të jashtëzakonshme, me kontribute të shquara profesionale e patriotike, ku më shumë se gjysma e kandidatëve garojnë për herë të parë. Kjo është lista e qytetarëve. Kjo është lista e Kosovës. Kjo është lista e Fitores", shtoi

## Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 12 JANAR** - Subjektet politike që garojnë për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 kanë hyrë zyrtarisht në fushatë zgjedhore, e cila do të zgjasë deri në orën 07:00 të datës 9 shkurt, kur do të nisë votimi. Në këtë garë zgjedhore marrin pjesë 28 subjekte politike me gjithsej 1 280 kandidatë. Ish-

kryeministra e ish-ministra synojnë ta udhëheqin qeverinë e re.

Të shtunën fushatën zgjedhore e kanë hapur LV-ja, PDK-ja, LDK-ja dhe Koalicioni për Familjen, ndërkaq të dielën koalicioni AAK-Nisma. Lëvizja Vetëvendosje e nisi fushatën me një tubim në Gjakovë, ku kryeministri, lideri i saj, Albin Kurti, në fjalën e tij tha se po paraqet projektin për katër vitet e





Krasniqi. "Votoni për shpresë. Votoni për një Kosovë ma të mirë. Votoni për Partinë Demokratike të Kosovës me numrin 131. Përgjigjuni kësaj thirrjeje me pozitivitet dhe unë ju premtoj një gjë qysh sonte. Më 9 shkurt, së bashku, do të ngritemi. Më 9 shkurt, së bashku, do të fitojmë", tha Krasniqi.

Këto janë zgjedhjet e dyta që Memli Krasniqi i udhëheqë si kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, pas zgjedhjeve lokale 2021, ku PDK fitoi në më së shumti komuna dhe ka numrin më të madh të asamblistëve. "Kjo fitore erdhi sepse ne promovuam kandidatët më të mirë që janë dëshmuar si liderë të denjë. Sot, unë jam krenar me 10 kryetarët e komunave nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, që janë kampionë të qeverisjes së mirë. Qytetarët shohin përtej logove dhe flamujve partiak. Sidomos në një vend të vogël si yni, ku është e lehtë të njohim njëri-tjetrin. Qytetarët kërkojnë njerëz që mund t'ju besojnë dhe t'i respektojnë për t'i udhëhequr. Dhe pikërisht për këtë arsye, jam thellësisht i bindur se Kuvendi i Ri dhe Qeveria e Re do të jenë shumë më të mira sesa këto që i kemi sot", tha Krasniqi.

Krasniqi nga Salla "1 Tetori" në Prishtinë ka përshëndetur dy liderët e UÇK-së dhe të PDK-së, Hashim Thaçin dhe KadriV eselin, si dhe Jakup Krasniqin e Rexhep Selimin, dhe shokët e tyre që po zhvillojnë betejën e fundit në Hagë për drejtësinë e luftës çlirimtare të popullit tonë. "E di që sikur mua, po ju mungojnë shumë secilit prej jush, e mezi po e presim rikthimin e tyre në Kosovë, pranë familjeve e miqve, por, deri atëherë, le t'ua bëjmë një premtim. Kosovën do ta bëjmë ma të mirë, sepse kjo është ajo që ne bëjmë dhe kemi bërë gjithmonë. Partia Demokratike e Kosovës është gati për këtë detyrë. Partia Demokratike e Kosovës është gati për fitore", tha Krasniqi.

Ndërkaq kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, duke i falënderuar të

pranishmit dhe të gjithë qytetarët për mbështetjen, është zotuar për rritje të pagave dhe pensione, zhvillim ekonomik, siguri energjetike, sigurime shëndetësore, arsim cilësor, si dhe kultivimin e raporteve të mira me aleatët. "Kemi shumë shembuj të qytetarëve që e kanë vendosur Kosovën të parën. E kanë vendosur Kosovën edhe para vetes. Gjatë kësaj fushate kam pasur nderin të takoj shumë heronj të përditshmërisë tonë. Kam takuar burra, që me duar të plasaritura sigurojnë bukën e përditshme. Nëna që me forcë të pashtershme i mbajnë familjet. Kam takuar të rinj të talentuar, gjithandej Kosovës, të cilët me energji të madhe punojnë për një të ardhme ma të mirë. Janë këta njerëz, forca e heshtur e Kosovës, ata që më inspirojnë. Ata më bindin se mund ta ndërtojmë një Kosovë, ku çdo sakrificë shpërblehet. Ky vizion për një Kosovë ma të mirë, ku secili qytetar përparon, nuk është një ëndërr. Është premtim. Një premtim për çdo familje, çdo të ri e të re, çdo të moshuar, që do të punoj pa u ndalur për t'ua përmirësuar mirëqenien në shtetin tonë. Po, Kosova mundet ma mirë", tha Hamza.

Kandidati i PDK-së për kryeministër u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve të zhgënjyer që në të kaluarën e kanë votuar partinë në

pushtet, të besojnë se Kosova mundet ma mirë. "Dua t'u drejtohem edhe atyre që në të kaluarën e kanë votuar partinë në pushtet. Atyre që e kanë humbur shpresën dhe ndihen të zhgënjyer ose të lënë pas dore. Shumë prej jush, para katër vitesh, me mirëbesim votuat për ndryshim. Por, tani keni mbetur të zhgënjyer nga premtimet e thyera dhe fjalët që nuk u mbajtën. Unë mund të flas shumë për dështimet e shumta të kësaj qeverie gjatë katër viteve të fundit. Për stagnimin ekonomik, për izolimin ndërkombëtar, për përkeqësimin e mirëqenies së qytetarëve tanë, për ngritjen e çmimeve e shumë dështime të tjera me pasoja të mëdha për shtetin dhe juve. Por, sot e konsideroj shumë më të rëndësishme që t'ju shikoj në sy secilin prej jush dhe t'ju kërkoj të besoni përsëri", theksoi Hamza.

Hamza tha se Kosova meriton më shumë mundësi, dinjitet e prosperitet dhe kjo arrihet duke e votuar PDK-në. "Le të ecim përpara të bashkuar dhe të vendosur. Ju jeni fryma e ndryshimit dhe forca e zhvillimit. Ju jeni ata që nuk u lëkundët kurrë. Ata që besoni se Kosova meriton ma shumë. Vendosni për PDK-në dhe Kosovën që mundet ma mirë! Zgjidhni të ardhmen!", ka përfunduar kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza.

## Abdixhiku: 9 shkurti po vjen. Ndryshimi po vjen

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se po shënojnë fillimin e një kapitulli të ri për Kosovën. "Sonte shënojmë një moment definues të historisë së popullit tonë! Sonte shënojmë kryengritjen e djathtë kombëtare - si thirrje monumentale e popullit të Kosovës! Dhe ju them, ju premtoj, zotohem, se çfarë kemi nisur sot këtu, do të kushtrojmë fort e do të mbahet në mend gjatë, jo vetëm gjatë këtij muaji elektoral, por do të kushtrojmë fort e gjatë, për gjenerata të tëra që do të vijnë pas. Do të shikojmë me mburrje në këtë 11 janar, e do të kuptojmë, se ndryshimi i shkurtit nisi mu në këtë sallë! Nga kjo sallë LDK është ngritur në këmbë! Është ngritur në këmbë për t'u mos u ndalur. Sepse kur LDK ngritet në këmbë, s'ka asgjë që e ndanë, s'ka asgjë që e ndalë!", ka thënë Abdixhiku, duke shtuar se në republikën tonë kryeministri nuk vendoset mbi prokurorinë, kryeministri nuk mbron hajninë. "Në republikën tonë pushteti nuk sulmon mediet, gazetarë e fjalën e lirë. Jemi popull i lirë, e duam lirinë, do ta mbrojmë lirinë! Në republikën tonë propaganda nuk zëvendëson realitetin me tabela fiktive përplot mashtrime. Në republikën

tonë, tabela e vetme është ajo e familjeve kosovare që jetojnë, punojnë e përpiqen për një jetë të dinjitetshme e të ndershme", ka thënë ai.

Abdixhiku ka thënë se 9 shkurti po vjen. "Ndryshimi po vjen. Dhe ora e madhe e ndryshimit ka nisur numërimin prapa! Ky numërim na sjellë tek e vërteta. Tek e vërteta e popullit të Kosovës. Dhe këtë të vërtetë e kam gjetur mes njerëzve tanë", ka thënë Abdixhiku.

## Haradinaj: Albin, shko!

Lideri dhe kandidati i AAK-së për kryeministër, Ramush Haradinaj, ka kritikuar ashpër kryeministrin Albin Kurti në hapjen e fushatës në sallën "1 Tetori" në Prishtinë. Haradinaj ka thënë se Albin Kurti duhet të largohet nga pushteti pasi, sipas tij, është njeri i lig dhe mashtrues. "Albin Kurti është njeri i lig. Klika e tij janë njerëz të ligj. E njerëzit e ligj e vijnë kohën e keqe, e mandej vyejnë njerëz të zotë, dhe ja ku i keni njerëzit e zotë. Duhet me heq mashtruesin për të fituar Kosova. Pse duhet me heq? Mashtruesin me heq se duam siguri të plotë e të përgjeshme, duam NATO e miqësi me Amerikën, prandaj duhet me heq mashtruesin. Nuk duhet të bëhen lojëra me siguri nacionale pas shpinës së aleatëve e në interes të Rusisë e Serbisë nga argati i tyre. Shko Albin, shko Nagip, shko Dejonë se s'dojmë me na vjedh", ka thënë Haradinaj, duke bërë thirrje që të votohet koalicioni i AAK-së.

Lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, në hapjen e fushatës elektorale në Prishtinë, ka thënë se është koha që ta çojnë Kosovën drejt NATO-s. Ai ka thënë se rreth koalicionit AAK-Nisma janë bashkuar njerëz që kanë vepra. "Ne bëjmë ligjin e ushtrisë, dhe koha është që ushtrinë ta çojmë në NATO dhe ky koalicion do ta bëjë. Haradinaj, ne e shumë rreth tij, kudo që jemi futur, i kemi sjellë fitore Kosovës, vepra, e jemi bashkuar për t'i vazhduar veprat për Kosovën", ka thënë Limaj.



## Hamza: Gratë duhet vetëm t'i paraqesin projektet biznesore, financimin fillestar do t'ua garantojë shteti

**SHTIME, 12 JANAR** - Kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, gjatë qëndrimit në qytetin e Shtimes, ka pasur një tubim edhe me gratë e kësaj komune. Hamza ka thënë se gratë në Kosovë do të mbështeten me projekte konkrete, që ato të kenë hapësirë dhe mundësi për një jetë aktive ekonomike, sociale, kulturore dhe arsimore. "Për gratë, 30 % subvencione për të gjitha ato që dëshirojnë ta zgjerojnë biznesin. Për ato që duan të hapin biznes për herë të parë, përkrahje me grante, para pa kthim. Do t'i prezantojnë idetë e tyre, vizionin e tyre, ndërkaq financimin fillestar do ta garantojë shteti", ka thënë Hamza.

Ai ka thënë se familjet dhe nënat

e reja do të mbështeten edhe me nga 100 euro në muaj si subvencione për fëmijët që detyrohen t'i regjistrojnë në çerdhet private për shkak të pamundësisë së regjistrimit të tyre në çerdhet publike. "Për nënat e reja të cilat kanë nevojë t'i dërgojnë fëmijët në çerdhe dhe kapacitetet në shumë komuna të Kosovës në çerdhe publike nuk janë të mjaftueshme, çdo muaj për secilin fëmijë nga 100 euro subvencionim do të kenë prej shtetit", ka thënë Hamza.

Kandidati i PDK-së për kryeministër sot i ka takuar edhe banorët e Reçakut. Hamza ka thënë se Reçaku është një thirrje për të mos harruar, por edhe për të punuar shumë për një të ardhme më të mirë.



## Osmani në takim me kryetarin e Bujanocit: Kosova do të vazhdojë t'i mbështesë shqiptarët e Luginës



**PRISHTINË, 12 JANAR** - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë kësaj jave ka pritur në takim kryetarin e komunës së Bujanocit, Arbër Pajaziti, së bashku me ekipin, të cilëve u ka uruar suksese të mëtejme në detyrën e përfaqësimit të interesave të qytetarëve të Bujanocit. Sipas njoftimit për medie, thuhet se gjatë takimit Osmani rikonfirmoi përkushtimin e institucioneve

të Republikës së Kosovës për t'i mbështetur vazhdimisht shqiptarët që jetojnë në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë për realizimin e të drejtave të tyre në përputhje me standardet më të larta për të drejta të njeriut. "Po ashtu, në këtë kontekst, presidentja dhe kryetari Pajaziti diskutuan edhe për lehtësimin e procedurave të shtetësisë për qytetarët nga këto komuna, duke theksuar

rëndësinë e adresimit të sfidave me të cilat përballen ata. Kryetari i Bujanocit falënderoi presidenten për ngritjen e zërit për të drejtat e shqiptarëve në Luginë në të gjitha forumet ndërkombëtare, ndërkaq diskutuan edhe për një sërë iniciativash nëpërmjet të cilave mund të përkrahen shqiptarët në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc", thuhet në njoftimin e Presidencës.

## Kurti shkon tek Observatori dhe Planetariumi Kombëtar i Kosovës, fton qytetarët ta vizitojnë me fëmijët

**PRISHTINË, 12 JANAR** - Kryeministri Albin Kurti ka vizituar së fundmi Observatorin dhe Planetariumin Kombëtar në Rashincë të Shtimes. Këtë e ka bërë me dije vetë ai përmes disa fotografive të publikuara në "Instagram", i shoqëruar edhe nga bashkëshortja. Ai u bëri thirrje qytetarëve ta vizitojnë këtë vend, sidomos me fëmijët. "Rashinca e Shtimes e ka

vendosur vendin tonë në hartën ndërkombëtare të astronomisë me Observatorin dhe Planetariumin Kombëtar të Kosovës. I pajisur me teleskopin më të madh solar në Evropën Lindore të kompanisë SkywatcherUSA, ai është hapësirë e frymëzimit për shkencëtarët e rinj dhe vrojtuesit e apasionuar të universit të pafund. Për një përvojë të

veçantë e të paharruar ju ftoj ta vizitoni të gjithë, sidomos bashkë me fëmijët tuaj. Ky projekt është mbështetur nga Komuna e Shtimes, Ministria jonë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, dhe donatorë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me një vlerë totale prej 310 mijë euro dhe është i pari dhe i vetmi në vend", ka shkruar Kurti.



## KQZ-ja hap platformën online për akreditimin e vëzhguesve për zgjedhjet e 9 shkurtit

**PRISHTINË, 12 JANAR** - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se periudha e aplikimit për akreditimin e vëzhguesve për Zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës, të cilat do të mbahen më 9 shkurt 2025, është në vazhdim. Për ta lehtësuar procesin e aplikimit, KQZ ka funksionalizuar platformën online të aplikimit. Procesi i aplikimit ka dy hapa

kryesorë: Plotësimi i aplikimit: Përfaqësuesi i autorizuar i organizatave joqeveritare, organizatave qeveritare, ndërqeveritare, organizatave ndërkombëtare të specializuara në zgjedhje dhe të drejtat e njeriut, medieve, ose përfaqësuesi i shteteve të huaja, duhet të plotësojë të dhënat që kërkohen në platformën online të KQZ-së. Miratimi i aplikimit: Pas

aplikimit, Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFSP) do të shqyrtojë aplikimin dhe do të miratojë ose refuzojë. Pas miratimit, ZRCKFSP do të dërgojë kredencialet përkatëse për t'u qasur në platformë dhe për të plotësuar informacionin për personat që kërkojnë akreditimin.



# Çfarë importoi e eksportoi Kosova gjatë vitit 2024?

PRISHTINË, 12 JANAR - Kosova vazhdon të ketë bilanc negativ tregtar, ani pse ka një rritje të lehtë të vlerës së mallrave të eksportit. Njëkohësisht ka shënuar rritje edhe importi më 2024 krahasuar me vitin 2023. Gjatë vitit që lamë pas Kosova ka eksportuar mallra në vlerë 889 milionë euro, ndërsa ka importuar 6.38 miliardë euro.

Në vitin që lamë pas një prej produkteve më të eksportuara ishte energjia elektrike në vlerë afro 150 milionë euro, pasuar nga artikujt dyer e dritare në vlerë mbi 98 milionë euro. Derisa artikujt shufra prej hekurit zënë vendin e tretë në vlerë prej 93 milionë eurosh.

Në bazë të të dhënave zyrtare të Doganës së Kosovës, vendin e katërt nga produktet më të eksportuara nga Kosova e zënë mobileritë, shtretërit dhe dyshekët në vlerë mbi 92 milionë euro.

Rënie e vlerës së eksportit, krahasuar me vitin 2023, vërehet te produktet e plastikës dhe mobilierive e dyshekëve.

Ndonëse gjatë vitit 2023 vendin e parë për eksport e mbanin këta artikuj (dyshekët) në vlerë mbi 146 milionë euro.

Ndërkaq, Kosova gjatë vitit 2024 ka importuar më së shumti naftë dhe vajra, ku vlera e tyre arrin shifrën mbi 710 milionë e 300 mijë euro.

Pas kësaj, me rreth 678 milionë euro, Kosova ka blerë vetura dhe mjete të tjera të transportit.

Ndërkaq, vendin e tretë në import e zënë makineritë, veglat e punës, autopjesë e të tjerë të ngjashme në vlerë prej 464 milionë eurosh.

Sipas të dhënave të Doganës së Kosovës dërguar për "KosovaPress", në vitin 2024 Kosova ka importuar vetura më shumë në vlerë mbi 90 milionë euro krahasuar me vitin 2023.

Lidhur me këto dhëna tregtare drejtori ekzekutiv në Institutin GAP, Blend Hasaj, në një prononcim për "KosovaPress"



thotë se në 25 vjetët e fundit qeveritë nuk i kushtuan vëmendjen e duhur zhvillimit të kapaciteteve prodhuese në Kosovë. Si pasojë e importit të madh, Hasaj potencon se ndodh rritja e hovshme e çmimeve, duke ndikuar në ekonominë e përgjithshme të vendit. "Një problem në Kosovë ka qenë pikërisht që ndër vite, këto 25 vitet e fundit nuk ia kemi dhënë vëmendjen e duhur zhvillimit të kapaciteteve prodhuese brenda vendit. Pikërisht për këtë e pamë që edhe me rritjen e hovshme të çmimeve, ndikimi në ekonominë tonë ishte i drejtpërdrejtë. Ndonëse ne jemi ekonomi e vogël dhe është e pritshme që të jemi marrës të çmimeve. Lulahatja në tregjet ndërkombëtare të afektojë vendin tonë, ne sikur nuk e kishim asnjë pengesë që të themi të reduktohej pak goditja

nga rritja e çmimeve, pasi që nuk kemi prodhim të brendshëm", thotë Hasaj. Blendi Hasaj shton se duhet pasur kujdes me mekanizmat me të cilët përkrahen prodhimet vendore, për çka përmend se gjithçka duhet të jetë transparente. "Ne shumicën e gjërave, apo pjesën më të madhe e importojmë nga vendet e tjera dhe mungesa e kapaciteteve prodhuese në vend e ka dëmtuar ekonominë tonë. Sepse nuk kemi lejuar që paraja e cila fitohet këtu dhe të shpenzohet brenda vendit dhe të qarkullojë brenda vendit. Duhet të jemi shumë të kujdesshëm në formën apo mekanizmin të cilin e zgjedhim për t'i përkrahur prodhimet vendore dhe kjo të bëhet përmes mekanizmave të cilët janë tejet transparentë që mos të ketë qeveria një diskrecion apo mos të ketë forma të cilat

janë jotransparente për mbështetjen e prodhimit të brendshëm", potencon Hasaj. Ndërsa drejtori ekzekutiv i Grupit për Zhvillim LLC, Shenoll Muharremi, ka thënë se nga të dhënat e fundit zyrtare të eksportit, sugjerojnë që Kosova gjatë dhjetorit 2024 ka shitur energji elektrike jashtë vendit prej 578,477 MWh. "Ky është një kapacitet i jashtëzakonshëm që nuk besoj se ka ndodhur ndonjëherë më parë. A ka kjo lidhje me reduktimet dhe terrin që qytetarët dhe bizneset e Kosovës e përjetuan? Nuk e di", ka shkruar Muharremi. Ai, po ashtu, ka shkruar se, kur gjurmohen eksportet, kuptohet se Kosova ka eksportuar 94 milionë euro energji elektrike gjatë dhjetorit 2024, kryesisht në Shqipëri (shumicën), por edhe në Slloveni dhe Maqedoni të Veriut. "Ky vëllim dhe vlerë kaq e lartë e energjisë së shitur ka

ndodhur gjatë dhjetorit, kur Kosova, familjet dhe bizneset, janë ballafaquar me një krizë energjetike të brendshme, ku disa biznese janë mbyllur se nuk kanë mundur të operojnë", shkruan ai.

Zyrtarë të Doganës kanë thënë për "KosovaPress" se nga janari deri më 17 dhjetor më 2024 Kosova eksportoi mallra në vlerë prej 889 milionë e 302 mijë eurosh, ndërsa importi ishte 6 miliardë e 38 milionë euro.

Në vitin 2023 vlera e eksporteve ka qenë 819 milionë euro, importi 5 miliardë e 878 milionë euro.

Në vitin 2022 eksportet kanë qenë 920 milionë euro, importet 5 miliardë e 639 milionë euro, më 2021 ishin 755 milionë eksporte, kurse importet 4 miliardë e 684 milionë euro.

Më 2020 vlera e eksporteve 474 milionë euro, kurse 3 miliardë e 296 milionë importe.

## Nga janari pagat dalin me rritje, por pse s'u trajtuan dilemat ligjore?

Prishtinë, 12 janar - Në fund të muajit tetor Qeveria e Kosovës mori vendim për rritje të pagave në sektorin publik. Kjo rritje u njoftua që do të bëhet me dy faza, dhe faza e parë u tha se do të fillojë në janar të vitit 2025.

Rrjedhimisht 55 euro nga ky muaj, kurse 55 euro të tjera nga korriku.

Kjo u bë përmes Ligjit për Buxhetin, duke rritur koeficientin varësisht nga pozita për 0.5 njësi për gjashtëmuorin e parë të vitit, kurse edhe 0.5 njësi nga korriku. Por sikur kohën kur u paralajmërua vendimi, ashtu edhe tani kur është afuar koha



për zbatimin e tij, dilemat ligjore ekzistojnë ende. Rritja e njësive përmes buxhetit dhe jo rritja e koeficientit

përmes ndryshimit të Ligjit të Pagave vazhdon të vlerësohet e kundërligjshme nga juristët. "Çdo ndërhyrje në strukturën e

koeficientit në pajtim me nenin 42 të Ligjit të Pagave është kundërligjore, prandaj insistimi dhe procedimi në këtë formë siç është bërë, për bindjen time, është në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit për Pagat në sektorin publik", ka deklaruar për "TV Dukagjini" juristi Ardian Bajraktari.

Ndërsa avokati tjetër, Anton Nrecaj, thotë se kjo situatë është konfuze për shkak se, sipas tij, nuk është bërë plotësimi i dispozitave ligjore të dala nga rekomandimet e Gjykatës Kushtetuese për Ligjin e Pagave. "Çfarëdo lloj vendimi që do të nxirret do të jetë një

thikë me dy tehe për Qeverinë e Republikës së Kosovës, për shkak se ka neglizhuar, respektivisht nuk e ka respektuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese në mënyrë që të përfundojë epilogu i dramës së Ligjit të Pagave në sektorin publik", ka deklaruar Nrecaj.

Problemet ligjore të vendimit për rritjen e pagave, sipas njohësve të ligjit, mund të konstatohen vetëm nga Gjykata Kushtetuese. Por, pavarësisht prej dilemave të ngritura publikisht, asnjë prej palëve të autorizuar në fushën politike nuk e ka dërguar këtë vendim në kushtetuese.

# Donald Trump po kërkon një botë më shumë amerikane... goftë edhe përmes pushtimeve ushtarake

Presidenti i zgjedhur në Shtetet e Bashkuara mbajti ndoshta konferencën më të rëndësishme të tij në vitet e fundit. Trump shfaq hapur politikën dhe synimet në këtë mandat të ri katër vjeçar: Presidenca e tij do të jetë e fokusuar jo vetëm në luftë tregtare, kryesisht me Kinën, por edhe në aspirata territoriale në dëm të vendeve aleate.

Trump kërcënoi hapur Panamanë për Kanalin dhe Danimarkën për Groenlandën me përdorimin edhe të forcës ushtarake, nëse Shtetet e Bashkuara hasin në rezistencë për të kaluar në kontrollin Amerikan. Kërkoj nga vendet anëtare të NATO-s që shpenzimet për mbrojtjen të kalojnë nga 2 për qind në 5 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto, riemërtimin e Gjirit të Meksikës në Gjirin Amerikan. Gjithashtu, Trump kërcënoi me një ferr të vërtetë në Lindjen e Mesme nëse Hamasi nuk liron pengjet izraelit nga Rripi i Gazës deri në betimin e tij si president. Sytë nuk i ka hequr për asnjë moment edhe nga Kanadaja fqinje, dhe ka nisur tashmë të konsiderojë si shtetin e 51 të SHBA-ve. Por ku do të ndalojnë valët sizmike të këtyre vendimeve që po trazojnë botën?

**Gazetari:** Lidhur me Groenlandën dhe Kanalin e Panamasë, a mund të garantoni ju botën se gjatë përpjekjeve për të marrë kontrollin e tyre nuk do të përdorni detyrime ekonomike apo ushtarake?

**Gazetari:** Mund të na tregoni planin tuaj? Do të negocioni një traktat të ri? Do t'i pyesni kanadezë të mbajnë një votim? Cila është strategjia juaj?

**Donald Trump:** Mund të ju garantoj se po flasim lidhur me Panamanë dhe Groenlandën. Nuk mund të ju konfirmoj diçka për asnjërin prej tyre, por mund të ju them se na duhen për sigurinë ekonomike. Kanali i Panamasë është ndërtuar nga ushtria jonë."

**Javier Martinez,** ministër i Jashtëm i Panamasë: Sovraniteti i Kanalit tonë nuk është i negociuesgëm dhe është pjesë e historisë sonë të mundimshme dhe një e arritur e pakthyeshme. Kanali ynë ka misionin për t'i shërbyer njerëzimit dhe tregtisë. Kjo është një prej vlerave që njerëzit e Panamasë i ofrojnë botës."

**Mette Frederiksen,** kryeministër

e Danimarkës: Dëshiroj që ta bëj shumë të qartë se në sytë e qeverisë së Danimarkës, Groenlanda i përket vetëm njerëzve të Groenlandës. Ata janë vërtetë një popull krenar me një gjuhë dhe kulturë më vete. Ashtu siç e ka thënë më parë dhe kryeterja e qeverisë atje, Groenlanda nuk është në shitje.

**David Sanger, Analist sigurie, CNN:** Në mandatin e tij të parë, mësuam dëshirën e tij për të blerë Groenlandën, gjë e cila nuk është plotësisht diçka e çmendur. Harry Tryman pati të njëjtën ide në vitin 1940, por shitësi nuk ishte i interesuar që ta shiste territorin. Në javët e fundit kemi parë mesazhe të shumta lidhur me Kanalin e Panamasë apo Groenlandën dhe ajo që nisi si një shaka për Kanadanë, tashmë është shndërruar në diçka serioze. Gradualisht është bërë e qartë për ne se në mandatin e dytë, ai dëshiron që të përdorë instrumentin e fuqisë Amerikane për të detyruar këtë zgjerim territorial. Nëse do të ketë sukses, ne nuk e dime, pasi është tepër e komplikuar. Danimarka është një vend aleat në NATO. Imagjinoni për një moment nëse ne përdorim forcën ushtarake për të detyruar Danimarkën të heqë dorë nga diçka. Pjesa tjetër e NATO-s do të detyrohej me artikullin 5 të NATO-s që të rreshtohet me Danimarkën kundër Shteteve të Bashkuara. Pra kjo do të komplikohet shumë shpejt.

**Aaja Chemnitz, Deputete nga Groenlanda, Parlamenti danez:** Mendoj se në shumë mënyra nuk është një çështje nëse ne duhet të jemi amerikanë apo danezë, por është një çështje nëse duhet të bashkëpunojmë pak më shumë me Shtetet e Bashkuara. Ne nuk duhet të blihem nga askush pasi Groenlanda nuk është në shitje dhe nuk do të jetë kurrë. Por ne mund të kemi një bashkëpunim më të ngrushtë në zhvillimin e biznesit me SHBA-të."

**Donald Trump, President i zgjedhur i SHBA:** Na duhet Groenlanda për qëllime të sigurisë kombëtare. Më është thënë prej shumë kohësh, madje edhe përpara se të garoja për president. Kemi rreth 45 mijë njerëz që jetojnë atje. Njerëzit vërtetë nuk e dinë nëse Danimarka ka ndonjë të drejtë ligjore mbi të. Por nëse kanë, duhet të heqin dorë, pasi na duhet për sigurinë kombëtare. Kjo është për botën e lirë, po flas për mbrojtjen e botës së lirë. Nuk



do ju duhen dylbitë për të parë, pasi aty jashtë keni anije të Kinës në mbarë vendin. Gjithashtu edhe anije të Rusisë. Nuk e di nëse Danimarka dëshiron që të arrijmë në një përfundim, apo nëse ka ndonjë të drejtë, pronësi apo interes, por njerëzit më shumë mundësi do të votojnë për pavarësi apo t'i bashkohen SHBA-ve."

Për rastin e Kanadasë ngurroi të konfirmonte kërcënimin e përdorimit të ushtrisë për ta detyruar të shndërrohej në shtetin e 51 amerikan. Por Donald Trump vazhdon me llogaritë e tij duke fshirë dhe vijë kufitare, të cilën e konsideroi diçka të panevojshme dhe plotësisht artificiale, teksa publikoi dhe hartën me Amerikën e Madhe. Për ta detyruar atë shtet drejt bashkimit, presidenti i zgjedhur njoftoi se do të përdorë presionin ekonomik me tarifa shumë të larta. Kjo ofensivë e Trump për të zgjeruar territorin, e gjen Kanadanë të dobësuar politikisht me një krizë të rëndë brenda vendit pas njoftimit të tërheqjes së kryeministri Xhastin Trudo. Megjithatë politikanët atje kanë sinjalizuar se do të vazhdojnë rezistencën për të qenë një shtet sovran. Pyetja që lind natyrshëm është se çfarë qëndron pas kësaj tentative të

Trump, kërcënimi rus? Zgjerimi i ndikimit ekonomik? Apo dëshira për të shkruar emrin në historinë amerikane?

**Gazetari:** A po konsideroni forcën ushtarake për aneksuar apo blerë Kanadanë?

**Donald Trump:** Jo. Por do të përdor forcën ekonomike, pasi Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara do të ishin vërtetë diçka domethënëse. Do të hiqim qafe atë vijë artificiale të kufirit dhe vetëm shikojeni se si do të dukej. Do të ishte diçka e mirë për sigurinë kombëtare. Po e mbështesim atë vend me mbi 200 miliardë

dollarë në vit. Kemi vendosur ushtrinë tonë në dispozicionin e tyre. Prandaj duhet të jetë një shtet i jonë. Këtë i thashë Trudo-s kur erdhi të më takonte. I thashë: çfarë do të ndodhte nëse ne nuk do t'i bënë këto gjëra për ju? Ai me tha se Kanadaja do të shpërbëhej."

**Doug Ford | Kryetar i Ontarios, Kanada:** E vlerësoj sensin e tij të humorit dhe gati sa nuk mendova të blinim Alaskën, por është diçka aspak realiste. Ne jemi një shtet sovran, jemi krenar dhe ne kanadezët, ashtu si amerikanë, jemi shumë krenar për vendin tonë. Ajo që dua të bëj është të sigurohem që ne të ndërtojmë një fortesë dhe të garantojmë që jemi më të fuqishmit, pasurit dhe dy vendet më të lulëzuara në mbarë botën. Ne kemi shumë për t'i ofruar SHBA-ve ashtu siç kemi pasur në vitet e fundit, pavarësisht nëse kanë qenë mineralet e çmuara apo energjia. Ne dëshirojmë që të sigurojmë se jemi të fuqishëm sëbashku. Kemi marrë dy kërkesa për të përforcuar kufirin, me të cilat pajtohëm 100 për qind, por ne po e bëjmë këtë gjë. Gjithashtu po përmbushim angazhimin e 2 për qindëshit në NATO. Kanadaja kryen tregti me Shtetet e Bashkuara për një vlerë 1.3 trilion dollarë. Ne jemi partneri tregtar më i madh për ta. Ne ndërtojmë 4.3 milionë fuçi naftë në ditë dhe energji elektrike, gjithashtu edhe minerale të çmuara. Kemi shumë fusha dhe sektorë, me të cilët plotësojmë nevojat amerikane dhe pse t'i dëmtojmë ata?"

Donald Trump nuk po dërgon lëkundje sizmike vetëm në politikën e fqinjëve të Amerikës, por edhe në Lindjen e Mesme, Europë dhe në Azi. Presidenti i zgjedhur kërcënoi me një ferr të vërtetë për Hamasin në Rripin e Gazës nëse nuk do të lirojë pengjet izraelite deri në ditën që do të bëjë betimin. Nuk mbështet një armëpushim në enklavën palestineze të shkatërruar nga

lufta dhe zotohet të përdorë çdo mjet për të dobësuar Iranin, shtet të cilin e ka shënjestruar si kundërshtar kryesor ushtarak. Tepër i paqartë shfaqet për konfliktin në Ukrainë të nisur nga Rusia. Trump ka premtuar të sjellë paqen me çdo kusht, gjë e cila nëse bëhet rrezikon që të çojë dëm të gjitha përpjekjet perëndimore për ta mbajtur tokën e Ukrainës të paprekur. Dyshime të mëdha ka ngritur për të ardhmen e kontinentit evropian me raportet që kërkon të vendosë me presidentin rus, Vladimir Putin.

**Donald Trump | President i zgjedhur i SHBA:** Putin thotë se NATO nuk duhet që të përfshihet kurrë në Ukrainë. Kjo duket sikur është shkruar në gur. Por përgjatë rrugës, Biden tha jo, ata duhet të anëtarësohen në NATO. Më pas Rusia do të kishte dike në portat e saj dhe prandaj unë e kuptoj atë që ata ndjejnë. Por shumë gabime janë bërë në ato negociata."

Donald Trump nuk është politikani i vetëm amerikan që po trazon botën. Krahu i tij i djathtë, njeriu më i pasur në planet, Elon Musk, ka zemëruar liderët kryesorë të europës duke mbjellë sherr dhe kaos politik në shtete të ndryshme, duke nisur me Francën, Italinë, Gjermaninë e deri në Mbretërinë e Bashkuar. Presidenti Emmanuel Macron, kryeministri Keir Starmer, kancelari Olaf Scholz dhe një numër udhëheqësish thuajse njëzëri përsëritën thirrjen ndaj Elon Musk që të ndalojë së ndëhyri në çështjet e brendshme dhe politikën e atyre shteteve. Shumë analizojnë se e gjitha po bëhet që të mbështeten disa forca politike të caktuara, kryesisht e djathta ekstreme, të cilët më pas mund të shndërrohen në aleatë shumë të fortë të presidentit të zgjedhur amerikan, Donald Trump.

Konferenca e parë e Donald Trump për këtë vit, i shfaq botës vetëm një trailer të një filmi 4-vjeçar që mund të ketë shumë të papritura, dinamika surreale, miq dhe armiq të rinj e të vjetër, por mbi të gjitha pasiguri për çështjet më të rëndësishme të botës. Ai premtonte paqe dhe zgjidhje të mosmarrëveshjeve, përmes disa mënyrave të konsideruara nga analistët, deri diku edhe si radikale.

(A2 Televizion)



# Pse Trump i 'qepet' Groenlandës dhe ambiciet e Ruisë dhe Kinës...



Në vitet e fundit, Arktiku është shndërruar në një arenë të re për rivalitetin global. Me shkrirjen e akujve si pasojë e ngrohjes globale, fuqitë e mëdha po luftojnë për kontrollin e një zone që premton jo vetëm pasuri natyrore, por edhe një rrugë detare strategjike. Në këtë kontekst, pretendimet e ish-presidentit amerikan Donald Trump për Groenlandën marrin një kuptim të ri.

## Rruga Veriore: Një "autostradë" e re globale

Rusia, e pajisur me flotën më të fuqishme të anijeve akullthyesë në botë, po përgatitet të shfrytëzojë avantazhin që i jep ngrohja globale. Që prej shpalljes së një "doktrine detare" më 2022, Moska ka bërë të qartë qëllimin e saj për të krijuar një Rrugë Veriore të hapur gjatë gjithë vitit, duke e shndërruar atë në një

korridor detar konkurrues në nivel global.

Pse kjo është kaq e rëndësishme? Aktualisht, rruga kryesore për transportin detar nga Kina në Evropë kalon përmes Kanalit të Suezit, një udhëtim që zgjat rreth 34 ditë. Por tensionet në Lindjen e Mesme dhe sulmet ndaj anijeve në Detin e Kuq e kanë bërë këtë kalim gjithnjë e më të pasigurt. Si alternativë, shumë anije po detyrohen t'i bien rrotull Afrikës, duke zgjatur udhëtimin në 48 ditë. Rruga Veriore e Arktikut, megjithatë, do ta bënte të njëjtin udhëtim për vetëm 23 ditë, me kosto shumë më të ulëta.

## Problemi i kontrollit të Ruisë

Moska pretendon se Rruga Veriore i përket ekskluzivisht asaj dhe ka vendosur rregulla që kërkojnë leje të posaçme

për çdo anije të huaj që dëshiron ta përdorë. Kjo shkel ligjet ndërkombëtare, por Rusia nuk e fsheh qëllimin e saj për të përfituar ekonomikisht dhe strategjikisht nga ky korridor.

## Ambiciet e Kinës

Ndërkohë, Kina, që e quan veten një "shtet thuajse arktik", po kërkon të konsolidojë marrëdhëniet e saj me Rusinë për të siguruar akses të privilegjuar në këtë rrugë. Që prej vitit 2018, Pekini ka shpallur një plan për të krijuar një "Rrugë të Re Polare të Mëndafshit", që do t'i mundësonte Kinës të transportonte mallrat e saj drejt Evropës me shpejtësi rekord. Në këmbim, Rusia do të përfitonte të ardhura të qëndrueshme dhe do të forconte marrëdhënien e saj me Kinën. Për Kinën, kjo rrugë nuk është vetëm një mundësi

tregtare, por edhe një alternativë strategjike për të importuar gaz dhe naftë nga Rusia, duke shmangur pikat e dobëta siç është Ngushtica e Malakës, e kontrolluar nga fuqitë perëndimore.

## Pse Groenlanda është në qendër të lojës?

Pretendimet e Trump për blerjen e Groenlandës më 2019 u panë fillimisht si një lëvizje e çuditshme. Por Groenlanda ka një rëndësi të madhe strategjike. Duke qenë e pozicionuar midis Amerikës së Veriut dhe Arktikut, ajo ofron një bazë ideale për të mbikëqyrur dhe konkurruar në zonën ku zhvillohet kjo garë globale për burime dhe rrugë detare. Ndërsa SHBA përpiqet të sigurojë një pozicion dominues në Arktik, Rusia dhe Kina vazhdojnë të mbeten ambigue ndaj ndryshimeve klimatike. Për

ta, ngrohja globale është një "e keqe e nevojshme" që hap dyert për fitime të mëdha. Ky qëndrim e ka bërë edhe më të vështirë bashkëpunimin global për të luftuar krizën klimatike.

## Një arenë e re për rivalitetin global

Në fund të fundit, interesat në Arktik nuk janë vetëm për pasuritë e tij natyrore apo rrugët e reja detare. Ato pasqyrojnë ndryshimin e ekuilibrave të fuqive në botë dhe rritjen e një rivaliteti të ri global. Pretendimet e Trump për Groenlandën, ambiciet ruse për Rrugën Veriore dhe planet kineze për një Rrugë të Re të Mëndafshit Polare janë vetëm disa nga elementët që tregojnë se Arktiku po bëhet "fronti i ri" i gjeopolitikës botërore. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Triumojnë Prishtina, Bashkimi dhe Peja

### “Epoka e re”

PRISHTINË, 12 JANAR - Në një ndeshje me shumë emocione e dramë deri në fund, Sigal Prishtina arriti fitore ndaj Borës me rezultat 86:83 (24:19, 18:22, 23:22, 21:20), në javën e 16-të të ProCredit Superligës. Në çerekun e parë, Bora kishte epërsi të lehtë, 2:7, por bardhekaltrit u rikthyen shpejt, për të fituar këtë pjesë 24:19. Vendasit vazhduan me lojë të mirë për të thelluar epërsinë në 35:24, por mysafirët u rikthyen shpejt, për të përmbysur shifrat në 39:41, derisa pjesa e parë u mbyll 42:41. Në periodën e tretë u zhvillua tërësisht lojë e barabartë, 23:22, ku shifrat në semafor pas 30 minutash ishin 65:63. Në dhjetë minutat e fundit u zhvillua dramë deri në

sekondat e fundit. Prishtina kishte epërsi 75:65, por Bora nuk u dorëzua dhe riktheu epërsinë në të mirë të saj, 78:81, duke bërë që fituesi të vendosej në fund. Bora ishte duke fituar 80:83, por në momentet vendimtare, Sigal Prishtina ishte më e vëmendshme, me gjashtë pikë radhazi për fitoren 86:83. Te vendasit u dalluan Ricky Tarrant me 25 pikë e pesë asistime dhe Rashid Mahalbashiq me 22 pikë e shtatë kërcime, ndërsa te mysafirët u dalluan Desmond Cambridge Jr me 26 pikë, shtatë kërcime e shtatë asistime dhe Adem Mekiq me 17 pikë e tetë kërcime. Sigal Prishtina ka tetë fitore e tetë humbje, ndërsa Bora pesë fitore e 11 humbje. Bashkimi po vazhdon në formë të lartë, ku mundi Vëllaznimi dhe



ndërpreu serinë pozitive të kuqezinjve, duke fituar 84:73 (24:17, 17:13, 27:18, 16:22), në javën e 16-të të ProCredit Superligës. Pas një fillimi të baraspeshuar, vendasit në fund të çerekut të parë ishin më të mirë dhe e përfunduan këtë pjesë në të mirë të tyre, 24:17. Prizrenasit për një nuancë ishin më të mirë edhe në periudhën e dytë, për të thelluar më shumë epërsinë dhe për shkuar në pushim me rezultat 41:30. Në periodën e tretë, vendasit ngritën më

shumë epërsinë, ku shifrat pas 30 minutash ishin 68:51. Në dhjetë minutat e fundit, kuqezinjët tentuan rikthimin, por nuk ia arritën qëllimit dhe Bashkimi triumfoi 84:73. Te vendasit u dalluan Jayveous Mckinnis me 24 pikë e 20 kërcime dhe Wendell Green me 20 pikë e tetë asistime, ndërsa te mysafirët më i miri ishte Jericole Helles me 23 pikë e dhjetë kërcime. Bashkimi numëron me 11 fitore e pesë humbje, ndërsa Vëllaznimi tetë fitore e tetë humbje. Ndërsa Peja fitoi sfidën ndaj Proton Cable Prizrenit me rezultat 96:80 (32:18, 16:25, 22:13, 26:24), në javën e 16-të të ProCredit Superligës. Verdhëzajt e nisën sfidën për mrekulli, duke pasur epërsi dyshifrore 10:0, e më pas ngritën epërsinë në 30:14, derisa çereku i parë përfundon

32:18. Prizrenasit nuk kishin udhëtuar me flamur të bardhë dhe u rikthyen në periudhën e dytë, që ishin më të mirë, 16:25, derisa pjesa e parë përfundon 48:43. Në fillim të periudhës së tretë, mysafirët ngushtuan epërsinë minimalisht në 48:47, por vendasit sërish u shkëputën, ku semafori pas 30 minutash tregonte rezultatin 70:56. Në dhjetë minutat e fundit u zhvillua lojë më e baraspeshuar, me Pejën që ruajti epërsinë dhe fitoi 96:80. Te vendasit u dalluan Tristan Ikpe me 11 pikë e shtatë kërcime dhe Tulio Da Silva me 20 pikë e pesë kërcime, ndërsa te mysafirët më i miri ishte Kwame Vaughn me 23 pikë e pesë kërcime. Peja ka nëntë fitore e shtatë humbje, ndërsa Proton Cable Prizreni ka katër fitore e 12 humbje.

## Nis kampi katërditor me futbollistët kandidatë potencialë për Kombëtaren e Kosovës

Prishtinë, 12 janar - Ka nisur kampi katërditor me futbollistët që shihen si kandidatë potencialë për t'u bërë pjesë e Kombëtares së Kosovës në të ardhmen. Përzgjedhësi Franco Foda ka ftuar në këtë grumbullim futbollistë nën moshën 21-vjeçare nga klubet vendore dhe ato evropiane. Qëllimi i këtij kampi është që të vlerësohen nga afër aftësitë dhe potenciali i secilit futbollist të grumbulluar, por njëherësh që edhe ata të njoftohen me strategjinë dhe filozofinë e lojës së Kombëtares A, për të qenë sa më të gatshëm për ekipin kombëtar. Në stërvitjen e parë, e cila u zhvillua të dielën në mbrëmje në

stadiumin “Fadil Vokrri”, morën pjesë të gjithë futbollistët e ftuar, me përjashtim të Drilon Hazrollajt, i cili nuk iu bashkua ekipit. Ekipit në grumbullim iu bashkua edhe portieri Miran Qela, pavarësisht lëndimit që ka pësuar në skuadrën e tij Munich 1980. Ndërkohë, për shkak të një problemi shëndetësor, përzgjedhësi Franco Foda mungoi në seancën e parë stërvitore, por ai do t'i bashkohet ekipit në seancën e nesërme, e cila zhvillohet në orën 11:00. E për ndjenjën e të qenurit pjesë e kampit stërvitor të Kombëtares A folën pas stërvitjes Etnik Brruti, Albin Gashi dhe Erion Avdija.



Etnik Brruti: “Normalisht është privilegj i madh për mua dhe secilin lojtar ta përfaqësojë Kosovën. Çdo njeri po e jep maksimumin në stërvitje. S'ka problem që është vetëm kamp stërvitor, pasi secili përgatitet

të jetë i gatshëm për ndeshje kualifikuese. Për momentin jam kapiten te Kombëtarja U21 dhe besoj që në një të dhme shumë të shpejtë do të arrij edhe në Kombëtaren A të Kosovës”, tha Brruti.

Erion Avdija: “Shumë mirë po më duket këtu me trajnerët e Kombëtares A dhe me lojtarët, shumë prej të cilëve i njoh dhe që kanë luajtur për ekipet e grupmshave të Kosovës. Stërvitja e parë kaloi shumë mirë, por i kemi edhe tri ditë. Kombëtarja A? Ky ka qenë gjithmonë qëllimi im, por kam kohë ende, jam i ri. Kombëtarja ka portierë të mirë, por mua më mbetet të punoj dhe të paraqitem mirë me klubin. Sigurisht se qëllimi i të gjithëve këtu është për të luajtur me Kombëtaren A”. Albin Gashi: “Është kënaqësi të luash për Kosovën. Është gjaku im këtu, babai im ka lindur këtu, familja ime është këtu dhe është ndjenjë e mirë”.

## Barcelona e shkatërron Realin në finalen e Superkupës së Spanjës

Jeddah, 12 janar - Barcelona e ka fituar Superkupën e Spanjës ndaj Real Madridit me rezultat 5-2, duke e dominuar takimin nga fillimi deri në fund. Në ndeshjen e zhvilluar në Jeddah të Arabisë Saudite, mbretërit arritën të shënonin që në start edhe pse katalanasit kishin dy raste. Vinicius Junior ‘vodhi’ një top nga Cassado, për të pasuar te Mbappe, i cili luajti bukur një me një me Balden për të shënuar për 1-0. Por katalanasit vazhduan me sulme dhe nuk u dorëzuan,

duke arritur golin e barazimit (1-1) në minutën e 22-të me Lamine Yamal. Në minutën e 35-të, Barcelona fitoi penallti pasi rasti u shikua në VAR, ku nga pika e bardhë ishte i saktë polaku Robert Lewandowski që shënoi për 2-1. Nuk vonoi shumë dhe erdhi edhe goli i tretë i Barcelonës, ku Kounde me një asistim të bukur gjen Raphinha i cili me kokë shënon për 3-1. Gjyqtari dha nëntë minuta lojë shtesë në pjesën e parë, ku në minutën e fundit, Barcelona me një super kundërsulm, arriti të

shënojë golin e katërt me Balde që mposhti Courtois për 4-1. Me të filluar pjesa e dytë, Barcelona arriti të shënojë golin e pestë në këtë takim, me Raphinha që gjeti rrjetën për 5-1 pas një aksioni të bukur. Në minutën e 56-të. Barcelona mbeti me dhjetë veta në fushë, kur Wojciech Szczesny u ndëshkua me karton të kuq pas një ndërhyrja jashtë zone ndaj Mbappe. Nga ajo goditje dënimi ishte Rodrygo që me një gjuajtje të bukur shënoi për 5-2. Edhe pse Real Madridi kishte raste, nuk arriti të zbut



epërsinë e Barcelonës, e cila po ashtu ishte afër të gjente rrjetën nga kundërsulmet. Barcelona edhe njëherë këtë

sezon tregohet më e mirë se sa Real Madridi, duke triumfuar kësaj radhe në finalen e Superkupës së Spanjës.



Kompania Regionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë  
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanisë Regionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë me datë 13.01.2025, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

## KONKURS

**Pozita : Ngasës i kamionit - 1 pozitë**

**Vendi punës : Pejë**  
**Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.**  
**Koeficienti i pagës : 2.2**

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Drejton automjetin, kujdeset për rregullsinë e tij dhe është përgjegjës për ngasjen e sigurtë, duke i respektuar rregullat trafikut rrugor dhe të sigurisë;
- Kujdeset për higjienën dhe pastërtinë e automjetit, si dhe para çdo ndezje të automjetit kontrollon gjithëmbarshtëm çdo pajisje dhe cep të automjetit dhe në momentin që vëren problem mekanik apo elektrik lajmëron kryepunëtorin, dhe nëse prishja ka ditë që nuk është rregulluar, lajmëron dhe MO, KE për problemin elektrik apo mekanik;
- Çdo ditë merr urdhëresën e punës nga kryepunëtori dhe koordinatori operativ në të cilën e shënon evidencën e punës dhe shpenzimeve;
- Është i obliguar që në automjet të ketë në rregull aparatin për fikjen zjarrit dhe pajisjet përcjellëse të domosdoshme në komunikacion;
- Çdo ndalje për mbledhjen e mbeturinës është i obliguar që ta bëjë sigurt dhe mundësisht në skajin e rrugës ose jashtë rrugës. Gjatë lëvizjes prapa dhe gjatë marrjes së mbeturinave me shpejtësi të vogël është i detyruar të lëshojë 4 treguesit drejtimor dhe çdo herë për çdo veprim në trafik rrugor të jetë i sigurtë se ai veprim do të bëhet pa shkakuar incident;
- Duhet të pajiset me certifikatë të rregullt shëndetësore për ngasje të automjetit dhe e njëjta të jetë valide;
- Nuk duhet të konsumojë duhan, alkool, apo narkotikë përgjatë drejtimit të automjetit, si dhe barëra të cilat kanë shenjë të trekëndëshit të sigurisë me ngjyrë të kuqe në vend të dukshëm;
- Në rast të prishjes së automjetit me të cilin punon është i obliguar që të drejton automjet tjetër dhe kryen edhe punë tjera me urdhëresë të Kryepunëtorit, Kordinatorit Operativ;
- Është i obliguar të menaxhojë dhe të mbajë nën kontroll ekipin e punëtorëve fizik;
- Është i obliguar të mbajë uniformën e ndërmarrjes dhe PPM (pajisjet personale mbrojtëse);
- Kryen punë bazuar në kontratën e punës, por edhe punë tjera me urdhëresë të Kryepunëtorit;
- Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV;
- Certifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

b. Kushtet e veçanta : (kualifikimet profesionale)

- Përgatitje profesionale - Shkollim të mesëm, kategori përkatese (C1-C);
- Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

**Pozita : Punëtor fizik në mbledhjen e mbeturinave - 4 pozitë**

**Vendi punës : Pejë**  
**Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.**  
**Koeficienti i pagës : 2**

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave;
- Mbledh mbeturinat dhe bën zbrazen e kontejnerëve dhe mjeteve të tjera për hedhurina apo qeseve nga shfrytëzuesit e shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror;
- Pas zbrazjes së kontejnerëve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthejë ato në vende të caktuara dhe për të të ketë kujdes;
- Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efektive dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve;
- Është i obliguar të mbajë uniformën e ndërmarrjes dhe pajisjet e tjera të punës dhe mbrojtjes në punë (PPM);
- Kryen punë bazuar në kontratën e punës por edhe punë tjera me urdhëresë të shoferit dhe kryepunëtorit;
- Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV;
- Certifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

b. Kushtet e veçanta : (kualifikimet profesionale)

- Të ketë njohuri për shkrim dhe lexim përparësi shkollim fillor;
- Aftësi fizike dhe psikike të dëshmuar;
- Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

**Pozita : Arkëtar- e - 1 pozitë**

**Vendi punës : Pejë**  
**Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.**  
**Koeficienti i pagës : 2.1**

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Pranon pagesat në të gatshme dhe plotëson fletëpagesën në dy kopje, kopjen e parë i'a dorëzon palës, ndërsa kopjen tjetër e mbanë s'i dëshmi dhe e arkivon;
- Në fund të çdo dite të punës printon "Arkëtimi sipas Dokumenteve Analitike" dhe i shton në programin e financave si "Mandat Arkëtim";
- Në fund të ditës përpilon ditarin e arkës mbi të hyrat dhe të dalurat dhe i'a bashkangjet dokumentacionin në gjendje të rregullt, i verifikuar nga personat e autorizuar, saldon e deponon brenda ditës në xhironlogarinë bankare të ndërmarrjes;
- Është i/e obliguar që t'i përmbahet maksimumit të mjeteve financiare të arkës për të cilën vendos kontabiliteti;
- Kujdeset për mjetet e pranuar duke i verifikuar me pajisje adekuate;
- Jep përgjegjësi për çdo pagesë të cilën e lëshon tek personat e pa autorizuar;
- Kushtet e përgjithshme :
- Kryen punë bazuar në kontratën e punës por edhe punë tjera me urdhëresë të kontabilistit;
- Është i detyruar të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore;
- Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv

a. Kushtet e përgjithshme :

- Një CV të detajuar;
- Certifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikatë mbi gjendjen shëndetësore .

b. Kushtet e veçanta: (kualifikimet profesionale)

- Shkolla e mesme, përparësi Diplomë Universitare;
- Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
- Njohja e punës me kompjuter;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

**Pozita : Zyrtar i teknologjisë informative (IT) - 1 pozitë**

**Vendi punës : Pejë**  
**Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.**  
**Koeficienti i pagës : 3.4**

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Mbikëqyr dhe menaxhon të gjitha aktivitetet e IT-së, përfshirë rrjetin, infrastrukturën e serverëve, "softuerin", bazën e të dhënave dhe aplikacionet në kuadër të ndërmarrjes;
- Këshillohet dhe mbështet të gjitha departamentet për nevojat e tyre operative dhe zgjedhjen e problemeve;
- Ruan dhe mbikëqyr asetet e IT-së duke u bazuar në politikat dhe procedurat e IT-së;

- Menaxhon kapacitetin e rrjetit, "harduerit" duke u siguruar që është në përputhje me kërkesat e biznesit të ndërmarrjes;
- Dizajnon, vlerëson dhe përcakton infrastrukturën e IT-së dhe mbikëqyr ofrimin e shërbimeve të IT-së për të gjithë personelin e ndërmarrjes;
- Kontribuon në zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë së IT-së;
- Mbikëqyr zhvillimin dhe zbatimin e politikave, procedurave, standardeve dhe udhëzuesve të IT-së;
- Kujdeset për menaxhimin e qasjes së përdoruesve dhe kontrollin e qasjes;
- Kujdeset për menaxhimin e riskut të IT-së, vazhdimësinë e operimit / funksionimit dhe rimëkëmbjen e sistemeve të IT-së;
- Monitoron sistemet e informacionit dhe sigurisë së informacionit;
- Administron projektet e IT-së dhe të ndryshimeve;
- Përcakton kërkesat funksionale për pajisje, "software", trajnime etj., në IT-së dhe mban kontakte me furnizuesit dhe kontraktuesit;
- Delegon detyra, udhëzon dhe kontrollon personelin e zyrës;
- Identifikon nevojat emergjente dhe planifikon ndryshimet në sistemet ekzistuese për të plotësuar nevojat e ndërmarrjes;
- Vlerëson teknologjitë e reja dhe aplikimin e tyre potencial në ndërmarrje;
- Identifikon nevojat e trajnimeve lidhur me teknologjinë për personelin e IT-së dhe tërë ndërmarrjes;
- Mbikëqyr progresin dhe efikasitetin e programeve trajnuese;
- Monitoron rrjetin LAN, WLAN dhe WAN. Kryen mirëmbajtjen, vlerësimin, instalimin dhe nëse është e domosdoshme ndjek trajnimet e nevojshme për të siguruar se performanca e rrjetit është në përputhje me kërkesat dhe nevojat e ndërmarrjes;
- Hulumton problemet e shfrytëzuesve, identifikon burimin e tyre, përcakton zgjidhjet e mundshme, teston dhe aplikon ato;
- Mbështet dhe mbikëqyr punën e personelit të zyrës në tërësi: në instalimet, konfigurimet, mirëmbajtjen e kompjuterëve, serverëve dhe të dhënave, rrjetet, kabllimin dhe pajisjeve tjera të IT-së.
- Detyrohet të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore;
- Kryen edhe detyra të tjera që mund të caktohen nga KE;
- Për punën e tij / saj i raporton dhe përgjigjet KE.

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV;
  - Certifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
  - Letër motivimi;
  - Kopja e letërnjoftimit;
  - Certifikatë mbi gjendjen shëndetësore.
- b. Kushtet e veçanta: (kualifikimet profesionale)
- Diplomë Universitare - Në fushën e Teknologjisë së Informacionit /Shkenave Kompjuterike/ Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike;
  - 1 vit përvojë pune e dëshmuar;
  - Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

**Pozita : Sigurim i Objektivit (Roje) - 1 pozitë**

**Vendi punës : Pejë**  
**Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.**  
**Koeficienti i pagës : 1.7**

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Përcjellë hyrje-daljen e palëve, punëtorëve dhe automjeteve;
- Daljen e punëtorëve pa leje paraprake, të parakohshme i evidenton në libër të veçantë;
- Palët duhet t'i japë fletëhyrjen dhe i orienton për në shërbimet për të cilat janë të interesuara;
- Është i obliguar për sjellje korrekte me pale dhe për qëndrim në vendin e tij të punës;
- Bënë sigurimin e objektit në të cilin është përcaktuar në bazë të planit mujor;
- Bënë shqimin e gjendjes së objektit dhe mjeteve kundër zjarrit dhe rregullësisë së tyre;
- Kontrollon dhe largon personat e paautorizuar dhe të dyshimt që ndodhen afër objektit.
- Ndërmerr masat e nevojshme në mbrojtjen e objektit nga dëkurit natyrore dhe për këtë lajmëron menjëherë shërbimet e specializuara;
- Pranon dhe dorëzon ndërrimin dhe për gjendjen e objektit e informon punëtorin e sigurimit të radhës;
- Obligohet që në vendin e punës të mbajë uniformën;
- Pas orarit të rregullt të punës nuk guxon t'i lejoj hyrjen e personave të paautorizuar, përveç zyrtarëve të lartë të ndërmarrjes;
- Është përgjegjës i përgjithshëm i materialit dhe automjeteve, gjatë kohës së orarit të punës, me rastin e marrjes dhe dorëzimit të detyrës;
- Ndalon personat dhe automjetet e pa autorizuar dhe ndalon huthjen e mbeturinave nga ana e popullatës lokale;
- Të kryej punë të cilat i besohen mbrenda ditës, të ketë kujdes në punë në mënyrë që mos të vjen gjerë të ndezja e mbeturinave;
- Në rast të ndonjë avarie, ta evitojë atë dhe të lajmëroj shefin e sigurimit dhe organet Kompetente;
  - o Ndiha e shpejtë - 194,
  - o Emergjencia Civile - 112, 41
  - o Zjarrfikësit - 193,
  - o Policia - 119
- Të punojë të shtunave dhe të dielave.
- Kryen punë bazuar në kontratën e punës, por edhe punë tjera me urdhëresë të shefit të sigurimit;
- Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv.

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV;
- Certifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikatë mbi gjendjen shëndetësore;

b. Kushtet e veçanta: (kualifikimet profesionale)

- Shkollimin fillor përparësi shkollimi i mesëm;
- Përparësi janë certifikimet në siguri
- Aftësi shumë të mira organizative
- Njohja e punës me kompjuter.
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

**Pozita : Autoelektricitist 1 pozitë**

**Vendi punës : Pejë**  
**Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.**  
**Koeficienti i pagës : 2.4**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen riparimin e instalimeve elektrike të automjeteve dhe makinave ndërtimore në punëtorin dhe terren;
- Është përgjegjës për funksionim të sistemit të ndriçimit të automjeteve, duke përfshirë dritat për ndriçimin e rrugës, dritat e pozicionit, sinjalizuesit, stop dritat, tahografët, dritat gabarite dhe të tjera të cilat përmes funksionimit e tyre, autoelektricitist është i detyruar që sa më parë t'i rregullojë dhe të mos lejojë që asnjë automjet të dalë në rrugë pa qenë në funksion të gjitha këto; Për çdo prishje të cilën e riparon apo nuk mund ta riporjojë me kohë do të marrë përgjegjësi dhe duhet ta njoftojë shoferin përkatës dhe kryepunëtorin;
- Kryen rregullimin e alternatorëve, pajisjeve akumuluese, si akumulatori, si dhe ndez automjetet në rastet emergjente kur nuk funksionon diçka tek pajisjet;
- Është përgjegjës për kualitetin dhe efikasitetin e punëve të kryera;
- Është i obliguar të mbajë uniformën e ndërmarrjes dhe pajisjet e tjera të punës;
- Kryen punë bazuar në kontratën e punës por edhe punë tjera me urdhëresë të Kryepunëtorit;
- Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv.

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV;
- Certifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

b. Kushtet e veçanta: (kualifikimet profesionale)

- Shkolla e mesme - përparësi drejtimi autoelektricitist;
- Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

**Mënyra e Aplikimit:**Dokumentacioni duhet të dërgohet në e-mailit krmambientikonkurs@gmail.com  
Data e për aplikim është nga 13.01.2025 deri me 28.01.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA  
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË  
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA  
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Datë, 13.01.2025

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë (01B-195, të datës 31.10.2024), nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë dhe akteve të tjera përkatëse të Institutit, Këshilli Shkencor i Institutit të Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë në mbledhjen e mbajtur më 27.11.2024 shpall:

### KONKURS

1. (1) Hulumtues i pavarur për Histori kulturore dhe studime gjinore- zgjedhje.

#### Kandidatët për Hulumtues i pavarur përveç tjerash duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte:

- Të ketë të regjistruara studimet e doktoraturës;
- Të ketë punime të publikuara në revista shkencore;
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit;
- Të ketë pjesëmarrje në konferenca shkencore, nga të cilat së paku një (1) ndërkombëtare;
- Aftësi për kërkime shkencore;
- Përparësi kanë kandidatët me botime shkencore;
- Preferohet njohja e gjuhës angleze.

#### Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Vërtetimin për vijimin e studimeve të doktoraturës;
- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse (MA);
- Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara sipas akteve në fuqi;
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- CV të së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të;
- Dëshmi për të arriturat shkencore (artikuj, libra, etj).

Zgjedhja e personelit shkencor dhe hulumtues të Institutit të Historisë "Ali Hadri" bëhet në pajtim me dispozitat në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri"-Prishtinë (01B-195, të datës 31.10.2024), nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, "Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve" dhe akteve të tjera përkatëse të Institutit.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetaret ditore, si dhe në faqen e internetit të Institutit të Historisë "Ali Hadri".

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen dhe protokollohen në adminstatën e Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, në adresën Eqrem Çabej nr. 111.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA  
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË  
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA  
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Datum, 13.01.2025

Na osnovu Zakona Br. 04/L-135 o naučnoistraživačkoj delatnosti - (Službene Novine Republike Kosova, br. 11/02 Maja 2013), Statuta Instituta za Istoriju "Ali Hadri" u Prištini (01B-195, od 31.10.2024. godine), člana 8 zakona br. 03/L-212 o radu, kao i Uredbe o postupcima za izbor i reizbor naučnih radnika i istraživača Instituta za Istoriju i drugim relevantnih akata Instituta, Naučno veće Instituta za Istoriju "Ali Hadri"-Priština na sastanku održanom 27.11.2024. godine objavljuje:

### KONKURS

1. (1) Samostalni istraživač za kulturnu istoriju i rodne studije - izbor.

#### Kandidati za samostalnog istraživača moraju, između ostalog, ispuniti sledeće uslove

- Da ima registrovane studije doktorata;
- Da ima objavljene radove u naučnim časopisima;
- Da je učestvovao u naučnim aktivnostima unutar i van zemlje;
- Da učestvuje na naučne konferencije, od kojih je najmanje jedna (1) međunarodna;
- Sposobnost za naučno istraživanje;
- Prednost imaju kandidati sa naučnim publikacijama;
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika.

#### Potrebna dokumentacija

Kandidati moraju dostaviti sledeću dokumentaciju:

- Uverenje o registraciji doktorskih studija;
- Diploma relevantnih studija (MA);
- Izvod iz matične knjige rođenih, ne stariji od šest meseci;
- Biografija uz koju se moraju priložiti odgovarajući dokazi radi potvrđivanja navedenih podataka;
- Dokazi o naučnim dostignućima (članci, knjige itd.).

Izbor naučnoistraživačkog osoblja Instituta za istoriju "Ali Hadri" vrši se u skladu sa odredbama Zakona br. 04/L-135 za istraživačko-naučnu delatnost (Službeni list Republike Kosovo, br. 11/02 Maja 2013), Statuta Instituta za istoriju "Ali Hadri"- Priština (01B-195, od 31.10.2024.) , člana 8. Zakona o radu br. 03/L212, "Pravilnikom o postupku izbora i reizbora naučnih radnika i istraživača" i drugim relevantnih akata Instituta.

Rok za podnošenje prijave je 15 dana od dana objavljivanja konkursa u jednom od dnevnih novina, kao i na zvaničnom sajtu Instituta za Istoriju "Ali Hadri".

Uz prijavu se prilažu kopije dokumentacije o stručnoj spremi, iskustvu i druga potrebna dokumentacija koja su potrebna za radno mesto za koje konkurišu.

Popunjeni zahtevi, zajedno sa pratećom dokumentacijom, podnose se lično ili putem pošte i evidentiraju u upravi Instituta za istoriju "Ali Hadri" u Prištini, na adresi: Ekrem Çabej br. 111, Priština.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





# TRADITË QË NGA

# 1992

